DELTA SECURITY

Bregu i Diellit
Rr. Enver Maloku , 108
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës

tel./fax. +381 38 [redacted]
mobile: +377 44 [redacted]
info@[redacted]
www.[redacted]

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
386/17
Datë/Datum 16.10.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

DELTA SECURITY SH.P.K

Nr. i AP: kostt-17-3289-2-1-1, Nr. i brendshëm: KOSTT5539-17-41-211211
(shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Kundër Vendimit te AK: **"Oper. Sistemi, Trans.dhe Tregu – KOSTT" SH.A**, për:

a. Eliminim te Ofertes ne kundërshtim me Ligjin dhe
b. Përzgjedhjen fitues Operatorin Ekonomik me ofertë të pa përgjegjshme, konform kritereve të Dosjes së Tenderit

Vlera e tenderit: 600,000.00 €, kohëzgjatja e kontratës 36 muaj.
Lidhur me tenderin me titull:
"Sigurimi fizik i Objekteve të KOSTT".
(shëno titullin e kontratës si në paragrafin II..1 të Dosjes së Tenderit)

të iniciuar nga: **OPER. SISTEMI, TRANS.DHE TREGU – KOSTT" SH.A**

(shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

në afatin ligjor parashtroj këtë:

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

DELTA Security SH.P.K
(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Enver Maloku, nr. 108
(Adresa)

Prishtinë — **10 000**
(Vendi) — *(Kodi Postal)*

038 [redacted] —
(Numri i telefonit) — *(Numri i faksit)*

Ekrem S. DRESHAJ
(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]
(adresa elektronike)

16 Tetor 2017
(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

DELTA SECURITY SECURITY COMPANY

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

Po [X] Jo [ ]

- 29.09.2017, përmes e-prokurimit, kemi parnuar Njoftimin nga AK, Letër standarde për tenderuesin e eliminuar.
- 03.10.2017, Kemi parashtruar tek AK, Kërkesën për rishqyrtim.
- 06.10.2017, kemi pranuar nga AK përmes postës elektronike shkresën "Reagim", reth kërkesës sonë.
- 12.08.2017, AK ka publikuar "Njoftimin për dhënie të kontratës"

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë e gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës:

Janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së si vijon:

Neni: 7, 17, 28, 59, 60 dhe 61 i LPP-së, si dhe

UA Nr. 4/2015, neni 5,

** *Sipas nenit 113 të LPP-së, OSHP-ja do të konfiskoj Sigurimin e Ankesës tuaj, nëse Paneli Shqyrtues konstaton se të gjitha apo cilado nga pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë të rrejshme apo mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues – AK, KOSTT SH.A, në procedurën tenderuese, në procedurë të hapur, në tenderin për **"Sigurimi fizik i objekteve të KOSTT"**, me numër të prokurimit: KOSTT-17-3289-**2-1-1, Nr. i brendshëm: KOSTT5539-17-41-211**.

AK, gjatë procedurës së tenderimi, nuk i ka respektuar dispozitat e ligjit të prokurimit publik të Kosovës, - LPP si më poshtë:

AK, ka shkelur Ligjin e prokurimit, Neni 7, nuk ka trajtuar barabartë ofertat e OE. Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi:

AK, gjatë vlerësimit të ofertave të OE ka përdorur kritere të dyfishta dhe ka vepruar në kundërshtim më dispozitat ligjore të LPP-së.
Nuk ka respektuar Nenin 7, nuk janë trajtuar të gjithë ofertat e OE të barabarta, me faktin se ka eliminuar OE Delta Security, me aryetimin se Oferta financiare e tejkalon buxhetin e parashikuar për këtë projekt.